

**VENDIM**  
**Nr.43, datë 14.7.2006**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT**

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.109, datë 22.2.2006 “Për normën e lejuar të faktorit të fuqisë”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.07.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria KESH sh.a. për përcaktimin e çmimeve të energjisë reaktive për subjektet jofamilare,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimeve të energjisë reaktive për subjektet jofamilare të kërkuar nga shoqëria KESH sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për shqyrtimin e aplikimit të paraqitur nga shoqëria KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**